



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURES: “Shërbim mirëmbajtje automjete”**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 98341110-9**

**Vlera e Fondit Limit: 1.250.000** (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH.**

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 10 (dhjetë ditë)** sipas\ Nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se “*Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.*”

**Procedura e këtij prokurimi është:** Procedure e Hapur e Thjeshtuar

**Kohëzgjatja në ditë/muaj:** 20 (njëzet) ditë nga nënshkrimi i kontratës

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të të prokurimit prok publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

#### b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojcës 2;

**Argumentimi:** Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituar.

#### c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

#### d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,*

*formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për cilësinë e produkteve sipas zërave të specifikimeve teknike të kërkuara.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me Nenin 43, pika 1 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

**Gjithashtu dhe në përputhje me Nenin 55, pika 4, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se:** "Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

### 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë servis/oficinë për realizimin e shërbimit:

- Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një servis/oficinë të përshtatshëm për kryerjen e shërbimeve për të gjitha llojet e mjeteve sipas specifikimeve teknike, në funksion të realizimit të kontratës, të përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit servisi/oficina duhet të jetë brenda territorit të qytetit të Tiranës.

Për përmbushjen e kësaj pike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK, të vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës, dokumentat që vërtetojnë pronësinë/qiranë ose huapërdorjen (çertifikatë pronësie/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Vendndodhja që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një **deklaratë** përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendndodhja	Statusi
1		Pronësi/qira/përdorim

- **Ambientet e servisit të jenë të survejuara me kamera** ose ruajtje me roje private.

Për plotësimin e kësaj pike, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë shoqëruar me foto të sistemit dhe elementeve të vëzhgimit të instaluar në këto ambiente, ose për ruajtje me roje private duhet të paraqesë kontratë shërbimi për ruajtjen dhe sigurinë fizike me roje private, të ambienteve të servisit.

*\*Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të inspektojë në vend ambientet e sipërpërmendura duke hartuar një proces-verbal, me qëllim verifikimin e kërkesave të sipërcituara.*

### 2.3.3 Operatori ekonomik në ambientet e servisit/oficinës, ku ushtron aktivitetin duhet të ketë pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, si më poshtë vijon:

- a. Reparti elektroauto, i pajisur minimalisht me: pajisje për diagnostikimin e automjeteve; bankë-provë për dinamo, motorino; aparat për regjistrim fenerësh; aparat për kontroll rrjedhjesh dhe mbushje me gaz i sistemit të kondicionimit.
- b. Reparti motorist, i pajisur minimalisht me: pajisje për matjen e komprimimit të motorëve diesel; pajisje për matjen e komprimimit të motorëve me benzinë; komperator, set mikrometrash, kalibrash e pajisje të tjera ndihmëse; pajisje për testimin e injektorëve; aparat për kontroll radiator uji.

- c. Reparti Xhenerik, i pajisur minimalisht me: minimalisht me 4 (katër) ura ngritëse për automjete (veturë/fuoristradë); aparat për furnizimin me alkool dhe nxjerjen e ajrit të sistemit të frenimit; aparat konvergjence për automjete; pajisje montim-çmontim gomash; pajisje balancim gomash; linjë testimi elektronik për sistemin e frenimit, amortizimit, xhokove e konvergjencës së mjeteve.
- d. Kompjuter për diagnostikimin e automjeteve, i pajisur me programe për automjetet sipas specifikimeve teknike të dst.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Deklarate nga operatori ekonomik që disponon këto mjete gjatë gjithë kohezgjatjes së kontratës shoqëruar me foto të ambienteve të servisit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht **1 (një) karrotrec**, për transportimin e automjetit të difektuar, i cili teknikisht e ka të pamundur lëvizjen deri në ambientet e kontraktorit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë:

- dokument që vërteton pronësinë ose qeranë (çertifikatën e pronësisë/ kontratë qeraje/ huapërdorimi të mjetit rrugor);
- dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Neni 40 pika 3 I VKM nr 285 datë 19.05.2021 parashikon se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar c) ***aftësinë teknike dhe profesionale*** dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet/ pajisjet teknike/ ambientet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, nenit 41, pika 6 “***Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës***”. Ne procedurën me objekt prokurimi “**Shërbim mirëmbajtje Automjete**” vendosja e kritereve të mësipërme (2.3.2./2.3.3/2.3.4) janë të domosdoshëme për të përmbushur me sukses dhe siguri kontratën objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të dorëzojë:

- Liçencën e kategorisë **VII.3.B.1**, “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”

**- Leje Mjedisi të Tipit B**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat, profesionale për ofrimin e shërbimeve objekt të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht – 5** punonjës (inxhinierë, përgjegjës teknik dhe specialistë të kualifikuar) për zbatimin e kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, Operatori ekonomik duhet të ketë:

- 1 (një) drejtues teknik
- 1 (një) inxhinierë mekanikë;
- 1 (një) specialist motorristë;
- 1 (një) specialist xhenerikë;
- 1 (një) specialist elektro-auto;

**Për punonjës in drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi:**

- kontratën e punës ku të jetë përcaktuar roli i tij si drejtues teknik.



- Diplomë universitare i profilit inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti (origjinale ose fotokopje të noterizuar).
- Dëshminë e aftësisë profesionale

**Për të vërtetuar se ofertuesi disponon personelin e kërkuar duhet të paraqesë:**

- për inxhinierin (mekanik):

- Kontratë pune
- Diplomë universitare sipas profilit të kërkuar (origjinale ose fotokopje të noterizuar).

- për specialistët (motoristë, xhenerik dhe elektro-auto) :

- Kontratë pune.

**Listëpagesat për periudhën 3 muajt e fundit**, (formularët E-Sig 025a) (për të verifikuar, se operatori ekonomik ka të punësuar punonjësit e mësipërm).

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur bazuar në nenin 41 pika 4 Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

- CERTIFIKATË EN-ISO 9001: 2015
- CERTIFIKATË EN-ISO 14001:2015
- CERTIFIKATË IATF 16949: 2016
- CERTIFIKATË ISO 45001:2018

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sa më sipër këto kritere janë vendosur pasi për nga natyra e objektit të kontratës që do prokurohet është tepër e rëndësishme që OE si zbatues i shërbimit e mirëmbajtjes së automjeteve të kryejnë veprimtarinë më standardet e kërkuara të cilësisë.

ISO 9001:2015 “Çertifikatë e Menaxhimit të Cilësisë”, përcaktohet si standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, në mënyrë që OE të kenë një sistem më të mirë menaxhimi, planifikim më të mirë të aktivitetit, zgjidhje më të shpejtë të problemeve, rritje të produktivitetit, fitimeve dhe reputacionit si dhe ndërmarrja e veprimeve të duhura për të përmirësuar vazhdimisht të gjitha aktivitetet e kryera nga operatorët ekonomik.

Certifikata EN-ISO IATF 16949:2016 është një standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të cilësisë në industrinë e automjeteve. Ky standard i siguron AK që Operatori ekonomik do ti ofrojë cilësinë dhe efikasitetin në të gjitha aspektet e procesit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve që AK disponon.

Certifikata ISO 45001:2018 është një standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ky standard i ofron AK një kornizë në krijimin e një ambienti pune të sigurt në mënyrë që Operatori Ekonomik të identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet e mundshme për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të tyre.

Certifikata EN-ISO 14001:2015 është standard ndërkombëtar që fokusohet në menaxhimin e ambientit. Ajo ofron një kornizë për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të menaxhimit të ambientit që ndihmon organizatat të reduktojnë ndikimin e tyre mbi mjedisin, të rrisin efikasitetin e burimeve dhe të përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullatore në lidhje me ambientin.

Certifikimi i organizatave sipas këtij standardi ndihmon në krijimin e një imazhi të mirë dhe në përmbushjen e kërkesave të AK për një menaxhim të përgjegjshëm të ambientit.

Në përfundim, theksojmë se Kriteret për kualifikim janë kërkuar që t’i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara (ekspert fushe i cili ka konstatuar tërësinë e shërbimeve që automjetet kanë nevojë)/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike të shërbimeve objekt prokurimi. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinare", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

#### NJËSIA E PROKURIMIT

Julia Gjika

Adhurim Saliu

Ana Cici